

**AKTI I THEMELIMIT**

**DHE**

**STATUTI I SHOQËRISË**

**Johnjohn Trade SHPK**

**THEMELIMI**

**Neni 1**

**Ortaku themelues**

- 1.1 Shoqëria **Johnjohn Trade SHPK** themelohet nga Ortaku i Vetëm Z. **Bill Stefan Lundgren**, i biri i Thorsten, shtetas suedez, lindur më 11.02.1956 në Horby, banues në Vastra Ryttmastaregatan 19, Malmo, Sweden, mbajtës i Pasaportës nr. 35294367 me numer Personal 560211-3911.

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2**

**Emërtimi**

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është **Johnjohn Trade**.

**Neni 3**

**Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4**

**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.



**Neni 5**

**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është per një afat te papercaktuar.

**Neni 6**

**Selia**

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: **Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Themistokli Germanji, Pallati Pegaso, Kat 7, Ap. 30 – Tirane.**
- 6.2 Administratori i shoqërise mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të crrregjistroje ato ekzistuese sipas ligjeve ne fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashte saj me vendim te Administratorit te shoqërisë.

**Neni 7**

**Emblema. Vula**

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemë dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnjë emblemë dhe vulën e saj.

**Neni 8**

**Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: Sherbime marketingu jashtë territorit te Republikës se Shqiperise nëpermjet telefonit dhe internetit. Projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nëpermjet shfrytezimit te të gjitha instrumentave, perfshire marketingun telefonik dhe instrumenta te tjera te marketingut nëpermjet internetit per tu shitur ekskluzivisht jashtë territorit

te Republikës se Shqipërisë. Tregetia e monedhave te huaja dhe e aksioneve apo letrave me vlerë. Sherbime te per gjithshme marketingu.

- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 9**

**Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10'000 (dhjete mijë) Leke.
- 9.2 Ortaku i Vetëm zoteron 1 (një) kuote, e cila eshte e barabarte me vleren e kapitalit.
- 9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

**Neni 10**

**Transferimi i kuotave. Kufizimet.**

- 10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlgimin e Ortakut të Vetëm.

**Neni 11**

**Rritja e kapitalit**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rindërtuar. Ortakët e rindërtuar pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 12**

**Zvogëlimi i kapitalit**

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin ortakut të vetëm reportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë.

### **ORGANET E SHOQËRISË**

#### **Neni 13**

##### **Vendimet e ortakut të vetëm**

13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm i saj.

13.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe percaktimin e shpërblimit per ta;
- Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe percaktimin e shpërblimit per ta;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore që dhe të raporteve të ecurisë së veprimit;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.

#### **Neni 14**

##### **Administrimi**

14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.

- 14.3 Administratori i shoqërisë eshte **Z. Bill Stefan Lundgren**, i biri i Thorsten, shtetas sudez, lindur më 11.02.1956 në Horby, banues në Västra Ryttmästaregatan 19, Malmö, Sweden, mbajtës i Pasaportës nr. 35294367 me numer Personal 560211-3911.
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
  - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
  - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
  - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
  - Të zhvillojë veprimitari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;
  - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitacione apo entitetë publike ose private;
  - Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
  - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm përmbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;
  - Të vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë;
  - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
  - Të ndërmarrë çdo veprimitari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm përbiznesin e shoqërisë në Shqipëri.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 15**  
**Viti finanziar**

- 15.1 Viti finanziar i shoqërisë përpunhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përashtim, viti i parë finanziar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

**Neni 16**

**Bilanci. Kontabiliteti.**

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve të tatumore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për opératione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 17**

**Te Ardhurat. Dividendi**

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund t'i kalojne ortakut te vetem.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortaku do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

**Neni 18**

**Likuidimi**

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Ortakut të Vetëm.
- 18.2 Me vëndimin e Ortakut të Vetëm caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rrith operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet përfundimin e tij. Në përfundim



të kësaj proçedure, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e proçedurave të likuidimit.

**Neni 19**

**Mosmarrëveshjet**

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

**Neni 20**

**Klauzolë mbyllëse**

- 20.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

**Tiranë, datë 01.02.2021**

**Johnjohn Trade SHPK**

*Ortaku i Vetëm:*

**Bill Lundgren**

